

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istog Municipality of Istog
	Nr. 11-04/21	Dt.05.02.2021	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji për mbrojtjen e tokës bujqësore 02/L-26 neni 11. Pika 1 dhe Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH -së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-4526 të datës 03.02.2021, të Biofarm Istog Sh.p.k. nga Istogu, për lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit ekonomik bujqësor Ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe rezervuarëve për akumulimin e ujit, bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Istogut aprovuar me datë 27.06.2019, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	"BIOFARM ISTOG" SH.P.K.		
Adresa:	Istog		
Telefoni:	[REDACTED]	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe rezervuarëve për akumulimin e ujit		
Emri i Projektuesit:	Ranxh 4 Studio sh.p.k		
Adresa:	Istog		
Telefoni:	[REDACTED]	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Zona(t) Kadastrale: Dubravë	Nr.i parcelave kadastrale: nr.364-3,379-4,369-0,368-0,367-1,365-1,370-1,371-1,370-2,371-3,377-2,378-2,375-4,375-2,376-2,367-	GPS Koordinatat:

	2,367-3,365-2,378-1,377-1,375-3,379-3 ZK Dubravë.	
--	---	--

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: Ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe rezervuarëve për akumulimin e ujit	

Me këtë vendim, poseduesit të Lejes Ndërtimore Biofarm Istog Sh.p.k i lejohej Ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe rezervuarëve për akumulimin e ujit në Dubravë

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e

licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi "Biofarm Istog" Sh.p.k. nga Istogu ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimin e sistemit të ujitjes dhe rezervuarëve për akumulimin e ujit në Dubravë

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.05/L-31 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Kushtet Ndërtimore (N.A)
- Vendimi për Pëlqim Mjedisor (N.A)
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri (N.A)
- Elaborati Gjeomekanik (nuk aplikohet)
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Tri kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e II-te
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorrie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror - MMPH.

I dorëzohet: Investitorit, Drejtorisë për Inspeksion ,Kësaj Drejtorie dhe QSHQ për arkivim.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS NË ISTOG

Planer Urban
ark. Rrustem Gashi i.d.

Planer Urban
ark. Rexhep Blakaj i.d.

3/3

